



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-9156/25 datë:25.04.2025



Npi – 01/152 datë: 29.04.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 29.04.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 29.04.2025 (e martë) në ora 15:00 h. në sallën e madhe të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti, znj.Arianita Beqa-Rraci nga UNMIK-u, si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 01.04.2025,
2. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Për diskutim publik)
3. Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete,
4. Informatë 4 mujore nga ZKKK-ja,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 01.04.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 01.04.2025.**

Pika 2

Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Kryetari e ka formuar një Komision për sa i përket Planit të Punës së Ekipit për të drejtat e Fëmijëve, kështu që edhe unë jamë anëtarë i këtij Komisioni. Si Komision kemi bërë një punë të mirë lidhur me hartimin e këtij Plani, tani pritet që të shkojë në diskutim

publik. Mendoj se është një dokument i rëndësishëm për sa i përket mbrojtjes dhe avansimit të të drejtave të fëmijëve.

z.Besnik Seferi: Plani për të drejtat e fëmijëve është me rëndësi, dhe ne duhet me e mirëpritë. Ky Plan përmbanë edhe një aspekt të gjithëpërfshirjes, për sa i përket edhe komunitetit pakicë, sidomos lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Me sa e kamë lexuar unë, këtu nuk ka kurrfarë ndasie, prandaj unë mendoj se duhet ta miratojmë rekomandimin për Kuvend që të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë propozoj që edhe zyrtari i KKKZ-së z.Muhamet Mehmeti me qenë anëtarë i këtijë Komisioni. Edhe unë jamë “Për” miratimin e Rekomandimit për Kuvend për ta nxjerrë në diskutim publik Planin e Punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me rekomandimin që në Komision të përfshihet edhe z.Muhamet Mehmeti.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -IV- për vitin 2025, të mbajtur më: 29.04.2025, unanimisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin e punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, me vërejtjen që në ekipin për të drejtat e fëmijëve të përfshihet edhe Zyrtari i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim z.Muhemt Mehmeti.**

Pika 3

Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Për sa i përket plotësimit të anëtarëve të Komitetit për Komunitete, mendoj se duhet të vjen propozimi nga ju si përfaqësues të komunitetit jo shumicë. Kështu që çfardo që ju propozoni unë jamë “Pro” me arsyetimin se ju më së miri i përfaqësoni interesat e komunitetit jo shumicë në institucionet e komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Asambleja duhet të ketë parasysh interesat e komunitetit jo shumicë në Komunën e Shtimes. Unë nuk do të ndalem te emrat konkret, por është e domosdoshme që të shikohet interesi i përgjithshëm, duke pas parasysh propozimet që vijnë nga partitë politike nga komuniteti jo shumicë.

z.Besnik Seferi: Është për mu absurde që nuk kemi propozime konkrete, kur mbledhja e Kuvendit është edhe pak ditë. Unë e di që kanë ardhur dy emra, është dashur me na informuar administrata. Mendoj se është kjo një pikë e ndjeshme sepse kemi të bëjmë me zgjedhjen e anëtarëve të këtijë Komiteti, me përbërje të anëtarëve nga Komuniteti jo shumicë. Unë mendoj se nuk kemi çka me i rekomanduar Kuvendit, sepse dihet që Komiteti për Komunitete duhet patjetër me u plotësuar.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Sa e di unë janë dërguar emrat e Rrahman Kadrija dhe të Arjeta Maliqit. Unë nuk kamë ndonjë rekomandim për Kuvendin. Ne më shumë duhet me u marrë me institucionin se sa me individin. Unë si Kryesues i këtijë Komiteti kush do që zgjedhet nga Kuvendi, unë kamë me bashkëpunuar me secilin.

Pika 4

Informatë 4 mujore nga ZKKK-ja

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Muhamet Mehmeti.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Përshëndetje. Është hera e parë e prezantimit të një Informate prej se ja kamë filluar punës në ZKKK. Unë do ta lexoj informatën por të kompletuar do ta keni në 6 mujorin e parë Janar-Qershor. (Shih dokumentin)

z.Arton Demiri: Përshëndetje. Desha me ditë për një kërkesë që e ka bërë Zekë Demiri nga Shtimja lidhur me ndërtimin e një muri mbrojtës te shtëpia e tijë që paraqet rrezik, deri ku ka arritur kjo kërkesë?

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Unë kam biseduar në zyre gojarisht me Zekën dhe i kamë treguar se nevojitet me sjellë një profakturë për këtë kërkesë. Më pastaj ai e ka sjellë profakturën

dhe aty ka qenë e paraparë shuma prej 7000 €. Kjo është një shumë e madhe për mundësitë e tona buxhetore, që nuk mund ta përballon zyra jonë. Ne do të shikojmë mundësi të tjera nëse mund të gjejmë për financimin e këtijë muri mbrojtës.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Ndoshta mundemi me e diskutu më në detaje këtë çështje me Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për me adresuar kërkesën për banim social, edhe për disa familje të tjera siç është psh. familja e Sherifit.

z.Besnik Seferi: Faleminderit Muhamet për informatën. Marrveshja e Komunës me OJQ-në "Jetimat e Ballkanit" është një mundësi për këto familje. Unë kam biseduar me përfaqësuesin e OJQ-së "Jetimat e Ballkanit" zotëri Agon Zhinipotoku lidhur me ndihmën për familjet me problemet e strehimit dhe banimit, dhe kam fjalë të mira për sa i përket mundësisë për ti ndihmuar këto familje edhe sa i përket familjes së Sherifit.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Desha ta diskutoj qështjen e pagesave për anëtarët e Komitetit për Komunitete, sepse nuk i kemi pranuar pagesat për muajin e fundit. Është mirë me e diskutuar këtë qështje sepse ka disa Komuna që anëtarët e Komitetit për Komunitete nuk i marrin pagesat qe një kohë. Jo zyrtarisht kam marrë informata se Komitetet për Komunitete nuk do të paguhen. Ne duhet fillimisht që ta diskutojmë këtë qështje me përgjegjësin për pagesa në Komunë. Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj dhe mbledhjen e përfundoj në ora 16:09h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

